



E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 419/4 Prot.

Tiranë, më 31.05.2024

V E N D I M

Nr. 165, datë 31.05.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 33, datë 07.03.2024, e z. M.P kundër Portit Detar sh.a Shëngjin¹, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”² dhe “*çdo shkak tjetër*”³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Unë M.P jam i diskriminuar për shkak të bindjes politike dhe për shkak se kam dalë në media duke u ankuar për keq menaxhimin dhe për rrogat e pa dhëna për punonjësit e portit. Këto shkaqe kanë nxitur drejtuesit që të më diskriminojnë deri në largimin nga puna. Në janar të vitit 2014 u emërova përgjegjës në sektorin zjarrfikës dhe kam kryer detyrat edhe të përgjegjës të rojeve, deri në vitin 2017. Në vitin 2017 më kanë larguar nga përgjegjësi i sektorit zjarrfikës duke më ulur pagën nga 45.000 në 40.000 lekë, vetëm për bindje politike. Këtu punova për 6 vite si specialist në sektorin zjarrfikës dhe në këtë punë, kam kryer me përpikëri të gjitha detyrat e ngarkuara nga shefat e sektorit. Në vitin 2023, Porti i Shëngjinit ra në krizë ekonomike ku punonjësit mbetën pa u paguar për 3 muaj. Ne si punonjës organizuam mediat dhe unë M.P së bashku me kolegë të mi, kemi dhënë intervista ku kemi cituar se shkak i

¹ Në vijim referuar edhe si Porti.

² Referuar Kartës së anëtarësisë nr. 12025, datë 22.06.2016, vërtetohet se M.P është anëtar i subjektit politik: Lëvizja Socialiste për Integrim.

³ Për shkak të pjesëmarrjes në protesta dhe denoncimit në media lidhur me shkeljen e të drejtave të punëmarrësve nga ana e Portit Detar sh. a Shëngjin.

falimentimit ishte keq menaxhimi nga drejtuesit e kësaj ndërmarrje, duke filluar nga drejtorët me radhë: E.P, Gj.P dhe S.M. Të tre këto drejtues keq menaxhuan dhe shkatërruan ndërmarrjen. Nga 127 punonjës të mbingarkuar të cilët një pjesë e tyre nuk kanë ardhur në punë për arsye se ishin të favorizuar si pjesë e Partisë Socialiste. Këta drejtorë në bashkëpunim me shefat e sektorëve i kanë paguar pa ardhur fare në punë. Gjatë kësaj periudhe nga 2017 deri më 2024 nuk kanë pushuar së kërkuari konfirmimin e votës dhe ja arritën qëllimit duke i kërkuar Këshillit Mbikëqyrës shkrirjen e vendit të punës si specialist zjarrfikës. Kështu që më larguan nga puna mua dhe dy kolegë të tjerë pa asnjë lloj motivacioni. Kanë arritur të lënë në punë punonjës pa arsim dhe që nuk i meritonin ato vende pune. Anëtarët e komisionit që bëri vlerësimin e vendit tim të punës, kanë marrë vërejtje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (viti 2020) për këto shkelje ligjore në punë, duke shfrytëzuar postin e tyre si shefa sektorësh. Me ardhjen e E.P si drejtor i Portit në vitin 2017 u hapën vende pune të pa nevojshme. Dhe me ikjen e E.P dhe me ndërrimin e tij me Gj.P është shkelur akoma më shumë fuqia punëtore. Pastaj erdhi ish nëndrejtori i portit, për të kryer detyrën e drejtorit. Një vit e disa muaj pa bërë asnjë prezantim me punonjësit dhe asnjë mbledhje për krizën ekonomike të krijuar si pasojë e keq menaxhimit që çuan Portin në falimentim. Prandaj u ngrit një komision prej 5 vetash. Ishte ky komision i cili vendosi largimin e punonjësve me anë të reformës, pa zbatuar kriteret që përmban rregullorja dhe Kodi i Punës. Në mes të punonjësve që nuk kanë ardhur në punë dhe kanë marrë rrogën për 6 vite, më kanë larguar dhe mua si Specialist Zjarrfikës, V.D si Sanitare dhe P.N, në sektorin Ngarkim-Shkarkimit, sepse kemi denoncuar në media këto afere korruptive që çuan portin në falimentim dhe kemi mbështetur në fushatë kandidatit e djathtë P.Gj”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga ana e Portit Detar Shëngjin.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 419/1, datë 12.03.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime dhe dokumentacion provues Portit Detar Shëngjin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
2. Në vijim të kërkesave respektive të Komisionerit, me shkresën me nr. 228, datë 27.03.2024, Porti Detar Shëngjin, depozitoi pranë KMD-së parashtrimet e tij, si dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar.

Pjesë e dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së⁴, është dhe Kërkesë - Padia drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me paditës: subjektin ankues, M.P, znj. V. D dhe z. P. N dhe subjekt të paditur, Portin Detar Shëngjin.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhen prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi, si njëri ndër tre paditësit, pranë Gjykatës, ndër të tjera, citohet se:

“...Ne si punonjës, unë, z. P. N dhe znj. V. D, organizuam mediat dhe kemi dhënë intervista duke cituar se shkaku i falimentimit të Portit, ishte keq menaxhimi nga drejtuesit e kësaj ndërmarrjeje, duke filluar nga drejtorët E. P, Gj. P dhe S. M.

Nga 127 punonjës të mbingarkuar të cilët një pjesë e tyre nuk kanë ardhur fare në punë për arsye se ishin të favorizuar si patronazhistë të Partisë Socialiste...na kanë larguar nga puna sepse kemi

⁴ Bashkëlidhur shkresës me nr. 297, datë 13.05.2024, të Portit Detar Shëngjin (në kuadër të ankesës së regjistruar pranë KMD-së me nr. 34, datë 08.03.2024, paraqitur nga znj. V.D, kundër Portit Detar Shëngjin).

denoncuar në media këto afera korruptive që çuan Portin në falimentim, por dhe për faktin që kemi mbështetur në fushatë kandidatin e djathtë z. P. Gj.

Kontrata Individuale e Punës lidhur ndërmjet palëve M.P, nr. 21, datë 03.01.2014 i cili ka filluar punë në Portin e Shëngjinit po në atë datë, për emërimin e z. M.P (paditësit), Përgjegjës në Sektorin Zjarrfikës. Kjo marrëdhënie pune ka përfunduar në mënyrë të njëanshme me datë 26.01.2024 me Urdhrin nr. 40, datë 15.01.2024, më pak se tre vite para daljes në pension, pa asnjë vërejtje ndër vite.

...Të tre paditësit duke vlerësuar largimin e tyre nga puna si të kundërligjshëm, i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë-padi, duke pretenduar se marrëdhënia e tyre e punës është rregulluar me kontratë punë pa afat dhe se zgjidhja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të njëanshme nga ana e Portit Detar të Shëngjinit, pa shkaqe të arsyeshme.

Nisur nga motivacioni i largimit nga puna, shkurtimit të vendit të punës, realisht disponojmë informacion që vendi i punës jo vetëm nuk është shkurtuar, por janë punësuar të tjerë në atë vend pune, persona që nuk i përkasin bindjeve politike siç i përkasin të tre paditësit e diskriminuar edhe për shkak të denoncimeve televizive mbi shkeljet ligjore në Port. Pra, përveç denoncimit në media mbi aferat korruptive, shkak tjetër të pajustificueshëm për largimin nga puna, përbëjnë edhe bindjet politike të djathta të paditësve, çka ka rënë ndesh de facto, me bindjet politike të majta të drejtuesve aktualë të Portit Detar të Shëngjinit.

...Përfundimi i kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme, referuar nenit 146, pikës c), shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. (Shkaqet abuzive (jo të arsyeshme) të zgjidhjes së kontratës së punës). Zgjidhja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, si rregull i përgjithshëm duhet të bëhet jo vetëm për shkaqe të justifikuara por edhe për shkaqe të arsyeshme, dhe referuar nenit 146, të Kodit të Punës, konsiderohet se një kontratë është zgjidhur pa shkaqe të arsyeshme, kur punëmarrësi ishte duke përmbushur detyrimin ligjor, por zgjidhja e kontratës është bërë për motive politike, racore, fetare, ...etj. Pra, siç shihet, shkaqet e paarsyeshme janë të një natyre të tillë, të cilat cenojnë punëmarrësin.

...punëdhënësi nuk mund të tejkalojë të drejtën e tij për të zgjidhur kontratën për çfarëdolloj shkak. Konsiderohet tejkallim dhe abuzim me të drejtën, kur zgjidhja e kontratës është bërë nga punëdhënësi për një motiv abuziv. Si të tilla, motivet/shkaqet abuzive në ndryshim nga shkaqet justifikuese janë të përcaktuara shprehimisht në ligje dhe janë të vetmet në llojin e tyre, motive shteruese.

...Ndërprerja e marrëdhënies së punës në mënyrë të papritur dhe pa shkak ligjor nuk përlligj zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës së bërë me paditësit. Marrëdhënia e punës është një marrëdhënie individuale konkrete, e cila kërkon detyrimisht motivacion specifik për zgjidhjen e saj, në rast se punëdhënësi mendon ta ndërpresë atë.

Çdo punëdhënës ka të drejtën legjitime që në çdo moment që e çmon të përshtatshme mund të ndërmarë nisma për të bërë ndryshime në strukturën organike të punonjësve të tij, qoftë për arsye financiare apo çdo shkak tjetër ligjor. Por nga ana tjetër, kjo e drejtë legjitime nuk justifikon faktin që për shkak të shkurtimit të vendit të punës (sepse paditësit kanë sjellë prova, foto, video, që ekzistenca e këtij konflikti ka nisur nga momenti që paditësit janë shfaqur mediatikisht për të denoncuar parregullsitë dhe korrupsionin në Portin Detar të Shëngjinit, dhe se janë marrë e punësuar në këtë strukturë punonjës të tjerë jo me të njëjtin arsim dhe pagesë) të fillojnë bisedimet dhe pas kësaj të largohen personat që janë në marrëdhënie pune, apo që janë planifikuar për t'u larguar, pasi në rastin e ankuesit punonjësi mund të ishte transferuar në një pozicion tjetër pune të përafërt apo të njëjtë me atë që kishte kryer më parë.

..... i referohemi shkakut të pajustificuar të zgjidhjes së menjëhershme, efektit negativ që ka patur në gjendjen shpirtërore të punëmarrësit, moshën më pak se tre vite prag pensioni të punonjësve, mundësinë e pakët të punësimit prag pensioni që kanë paditësit, gjendja shoqërore dhe familjare shëndetësore, kohëzgjatja e punësimit që krijon një zgjidhje e pajustificuar e kontratës së punës. Duke shtuar këtu edhe diskriminimin politik, në kundërshtim me parashikimet e Konventës Sociale Evropiane dhe të Direktivave të BE-së, mbi barazinë racore, politike, etj, që është i maskuar nga shkurtimet në buxhet nga ana e Portit të Shëngjinit, në shkelje të Kodit të Punës, ku përveç shkeljeve cituar më lart, kanë shkelur edhe nenin 146, pika 1/c) “shkel ndalimin e diskriminimit sipas përcaktimeve në këtë kod, dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në kërkesë-padinë e depozituar para Gjykatës, citohet ndër të tjera, se, veprimet e ndërmarra nga ana e punëdhënësit kundrejt paditësit M.P, janë në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore, ku garantohet mbrojtja nga diskriminimi, ndër të cilat citohen edhe neni 146, i Kodit të Punës, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe Konventa Sociale Evropiane dhe Direktiva e BE-së mbi barazinë dhe mosdiskriminimin.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit/Porti Detar Shëngjin, lidhur me largimin e tij nga puna, dhe ka kërkuar dëmshpërblimin përkatës si dhe rikthimin në punë, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadija në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiës. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadiës. Ai

mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*.

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për

pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 33, datë 07.03.2024, të z. M.P, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj⁵.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁶, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 33, datë 07.03.2024, të paraqitur nga subjekti ankues, M.P kundër Portit Detar sh.a Shëngjin, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, date 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, të Komisionerit.

⁶ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.